

VENDIM
Nr. 462, datë 30.5.2013

PËR DISA SHTESA DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 428, DATË 9.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I, pas paragrafit të fundit të pikës 2, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur për objektet që janë në pronësi të organeve të pushtetit vendor është marrë vendimi i këshillit të qarkut/bashkisë/komunës për privatizimin/tjetërsimin e tij dhe këto objekte janë miratuar për t’u përfshirë në procedurë privatizimi, por organi i pushtetit vendor përkatës nuk dërgon përfaqësuesin e tij si anëtar të komisionit të vlerësimit, ministri përgjegjës për privatizimin e pronës shtetërore i kërkon institucionit të prefektit përkatës të dërgojë përfaqësuesin që do të marrë pjesë në komisionin e vlerësimit.

Përfaqësuesi i prefekturës do të kryejë të gjitha procedurat për privatizim deri në dorëzimin e objektit.”.

2. Në kreun II:

a) pas paragrafit të fundit të pikës 10, shtohet paragrafi, si më poshtë vijon:

“Kryetari i komisionit të vlerësimit i dorëzon ekspertit vlerësues gjithë dokumentacionin e mësipërm dhe eksperti vlerësues harton raportin e vlerësimit për objektin përkatës. Eksperti vlerësues zgjedh metodën përkatëse të vlerësimit të objektit dhe mban përgjegjësi ligjore për vlerësimin e bërë dhe vlerën e përcaktuar.”.

b) pas pikës 17 shtohet pika 18, si më poshtë vijon:

“18. Në rastet kur në përbërje të pronës që privatizohet nuk ka objekte ndërtimore sipërfaqësore, por vetëm objekte ndërtimore nëntokësore, atëherë privatizimi do të bëhet vetëm për objektin dhe sipërfaqen e zënë prej tij, sipas inventarit të miratuar me aktin ligjor përkatës të institucionit administrues/pronar.”.

3. Në kreun III, pas paragrafit të fundit të pikës 33, të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur bashkë me objektin janë marrë me qira apo enfiteozë edhe makineri, pajisje, linja teknologjike, mjete xhiroje, inventar ekonomik etj., të cilat janë pjesë përbërëse të kontratës së qirasë dhe subjekti qiramarrës ka kryer investimin përkatës me vlerë mbi 150% të vlerës së truallit, atëherë shlyerja e vlerës së tyre të bëhet deri 80% me bono privatizimi apo me lekë privatizimi, sipas kërkesës me shkrim, të depozituar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) nga blerësi i objektit.”.

4. Kudo në vendim hiqen fjalët “... ose i certifikuar ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha